

SHOQËRIA "VEZA E FRESKËT" SHPK
ORTAKU I VETËM

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
"VEZA E FRESKËT" shpk

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e shoqërisë

Neni 1

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesi

Ortaku i vetëm i shoqërisë është **Dashnor Bregu** i biri i Dervishit , lindur në Sevran Skrapar , me datë 01. Gusht 1957 , mbajtes i kartes se identitetit nr .025859236 dhe banues në Tiranë në adresën: Rr. Llazi Miho , Pall 359, Njesia Bashkiake nr 6, Kombinat Tirane ,ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të quajtur

" **VEZA E FRESKËT** " shpk.

Neni 2

Organizimi

Shoqëria do të ketë emrin "VEZA E FRESKËT" dhe ajo do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

Themeluesi i shoqërisë është **Dashnor Bregu** i biri i i biri i Dervishit , lindur në Sevran Skrapar , me datë 01. Gusht 1957 , mbajtes i kartes se identitetit nr .025859236 dhe banues në Tiranë në adresën: Rr. Llazi Miho , Pall 359, Njesia Bashkiake nr 6, Kombinat Tirane ,ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të quajtur

" **VEZA E FRESKËT** " shpk.

Neni 3
Kohëzgjatja

Shoqëria "VEZA E FRESKËT" shpk është krijuar për të ushtruar veprimtarinë e saj për një afat të pacaktuar kohe.

Veprimtaria e saj, fillon nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Bizneseve dhe kjo veprimtari do të vazhdojë të ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe çdo ndryshim që do të bëjë shoqëria do të reflektohet në aktet e shoqërisë që janë të depozituara dhe regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Bizneseve.

Neni 4
Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne Tiranë, në adresën:

TIRANE Ish kombinati Misto Mame, Zone kadastrale nr 8240, nr pasurie 5/20A

Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet hapjes së degëve dhe zyrave të përfaqësimit. Hapja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit bëhet sipas parashikimeve të nenit 9 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 5
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria "VEZA E FRESKËT" shpk do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- Import-Eksport fruta, perime, agrume, import eksport produktesh bujqesore, produktesh blegtorale , Import eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice vezesh , baze ushqimore per blegtori dhe shpend. Importimin, eksportimin dhe tregtimin e mallrave, materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve te ndryshme, te karakterit publik, farmaceutik dhe stomatologjik, industrial, bujqesor, tregtar,

**SHOQËRIA "VEZA E FRESKËT" SHPK
ORTAKU I VETËM**

ushqimor dhe te sherbimeve ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj. Import-Export dhe tregtim me shumice dhe pakice te mobiljeve, aksesoreve mobilare, kuzhinave, elektroshtepiakeve artikujve te ndricimit etj. Import-Export dhe tregtim me shumice dhe pakice te pajisjeve hidrosanitare dhe aksesoreve te ndryshem qe i sherbejne ketij qellimi. Import-Export dhe tregtim me shumice dhe pakice te detergjenteve produkteve kozmetike bio kozmetike dhe bimeve medicinale. Krijimin e sherbimeve hotelerie, bar, restorante dhe turistike brenda dhe jashte vendit. Import -Export dhe tregtim me shumice dhe pakice te konfeksioneve veshjeve dhe aksesoreve qe i pergjigjen ketij qellimi. Tregtim te produkteve dhe sherbimeve te lartpermendura drejteperdrejt tek klientet ose on-line ne internet (ecommerce).

Shoqëria mund të kryejë dhe cdo veprimtari tjetër e cila është në ndihmë dhe e lidhur me objektin kryesor të veprimtarisë së saj.

**KREU II
KAPITALI**

**Neni 6
Kapitali themeltar**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë. i cili zotërohet si më poshtë:

- Ortaku themelues Dashnor Bregu zotërues i 1 (kuote) me vlerë 100.000 (njëqindmijë) lekë, i cili zotëron 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë është tërësisht paguar dhe i shlyer në favor të shoqërisë.

**Neni 7
Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëve, në përputhje me parashikimet e Nenit 87 të Ligjit 9901.

Neni 8
Çertifikatat e kuotave

Ortaku i vetëm ka të drejtë të përfitojë një çertifikatë për kuotën e zotëruar prej tij, e cila lëshohet nga ana e shoqërisë. Çertifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 9
Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10
Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

Ortaku i vetëm i shoqërisë me vendim, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga ana e ortakut të vetëm të shoqërisë.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë.



Neni 11
Blerja e Kuotave të Veta

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 12
Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Ortaku i vetëm mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Neni 13
Shpërndarja e fitimit

Ortaku i vetëm ka të drejtë të marrë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e nenit 8/1, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojë këtë certifikatë.

**Neni 14
Ushtrimi i veprimtarisë**

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë realizohet në bazë të leverdisshmërisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saj. Bilanci i aktivitetit të shoqërisë duhet të përfundojë dhe të jetë i miratuar brenda muajit mars të vitit pasardhës. Bilancet e shoqërisë mund të bëhen nga vetë shoqëria ose nga ekspertë të caktuar prej saj.

Shoqëria krijon fondet e saj, përveç krijimit të fondeve të detyruara sipas ligjit, të cilat do të përdoren për zhvillimin e zgjerimin e veprimtarisë saj sipas rregullave në fuqi. Përbërja e këtyre fondeve caktohet me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë.

Shoqëria është pronare e mjeteve të saj financiare dhe i disponon vetë ato.

**KREU III
ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE TË SHOQËRISË**

**Neni 15
Ortaku i vetëm i shoqërisë**

Ortaku i vetëm i shoqërisë, kryen të gjitha funksionet që ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ja ka njohur për tu kryer nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investimet;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



Neni 16 Emërimi i Administratorit

Administratori i shoqërisë është:

Erlisa Murtini e bija e Selmanit, lindur në Librazhd , me datë 14 Korrik 1991 , dhe banuese në Tiranë në adresën: Rr Rr. Metrush Luli , njesia bashkiake nr 4 Tirane, madhore dhe me zotësi të plota për të vepruar, mbajtese e dokumentit te identifikimit Pass nr . BG9709581.

Afati i emërimit të administratorit eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit fillon të prodhojë efekte pas regjistrimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.Mandati i administratorit fillon me datë 05.02.2018 dhe mbaron me datë 04.02.2023

Neni 17 Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë si dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

**SHOQËRIA "VEZA E FRESKËT" SHPK
ORTAKU I VETËM**

Vendimet merren nga ana e ortakut të vetëm, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**Neni 18
Perfaqësimi**

Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit 9901.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori nuk mund të delegojë detyrimet e tij ligjore.

**Neni 19
Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit**

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë.



Neni 20

Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorit

Administratori shpërblehet në bazë të Vendimit të marre nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e Nenit 97 të Ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 21

Kufizimet e Administratorit

Administratori i shoqërisë, i cili është njëkohësisht dhe ortak i vetëm i shoqërisë në ushtrimin e veprimtarisë së tij mban parasysh kufizimet që rrjedhin nga neni 13 i Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Ai në asnjë rast nuk lejohet të lidhë kontrata huaje dhe garancie me shoqërinë. Kontratat e tjera të lidhura midis këtij personi dhe shoqërisë regjistrohen në një procesverbal, i cili bëhet në zyrën qendrore të shoqërisë.

Në rastet kur ai vepron në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 dhe nenit 14/5 të statutit është vetë subjekt i dënimeve të parashikuara në nenin 13, pika 7 e ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe përgjigjet vetë në mënyrë solidare e shoqërisë me të gjithë pasurinë tij sipas parashikimeve të nenit 16 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 21

Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë dhe personave të tretë, kur gjatë veprimve të tij ai shkel ligjin, statutin ose për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Neni 22

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri

Marrëdhëniet e punës me punetoret që do të punësohen pranë shoqërisë "VEZA E FRESKËT" shpk rregullohen me kontratën e punës individuale që do të lidhet me secilin prej tyre.

KREU IV
VITI FINANCIAR- EKSPERTËT

Neni 23

Viti financiar i shoqërisë fillon me datë 1 Janar të cdo viti dhe mbaron me datë 31. Dhjetor të cdo viti.

Neni 24
Ekspertët

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin të veprimtarisë ekonomiko tregtar të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë të në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar me një gjë të tillë nga ana e ortakut të shoqërisë.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i certifikuar paraqet me shkrim raportin për nxjerrjen e rezultatit financiar të bilancit vjetor, si dhe për atë të kontrolleve periodike të kryera prej tij, të cilat është i detyruar t'i dorëzjë në kohë për tu shqyrtuar nga ana e ortakut të vetëm të shoqërisë.

KREU V
PRISHJA LIKUIDIMI

Neni 25
Prishja dhe likuidimi

Shoqëria "VEZA E FRESKËT" shpk priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetëm;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës.

**SHOQËRIA "VEZA E FRESKËT" SHPK
ORTAKU I VETËM**

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901.

Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

**Neni 27
Shndërrimi i shoqërisë**

Për aq kohë sa shoqëria është më një ortak të vetëm, ky i fundit ka të drejtë që me vendim të tijin të vendosë për shndërrimin, transformimin e shoqërisë në ndonjë formë tjetër të shoqërive tregtare, duke zbatuar rregullat në fuqi.

**Neni 28
Riorganizimi shoqërisë**

Shoqëria mund të ndahet të bashkohet me vendim të ortakut të vetëm të saj, për aq kohë sa kjo është më një ortak. Ky proces do të bëhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Pjesën IX të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 29
Baza ligjore**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë statut dhe legjislacionin në fuqi.

Për aq sa nuk parashikohet në këtë Statut do të zbatohen parashikimet e ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe të cdo ligji tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**SHOQËRIA "VEZA E FRESKËT" SHPK
ORTAKU I VETËM**

Njoftimet

Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

ORTAKU I VETËM

DASHNOR BREGU

